

Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 i Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në seancën e 20-të mbajtur më 20.05.2022, lidhur me Propozimin nr.03-1987/2 nga 18.05.2021 për marrjen e procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi 2 nga LSHMAAV, miratoi si më poshtë:

K O N K L U Z Ë

1. Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr. 10-1987/1 nga 13.05.2022 të SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup dhe përcaktoi shkelje të nenit 53 paragrafi 2 nga LSHMAAV.

2. Këshilli konkludoi se ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup të inicohet procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi i përmendur më 26 prill 2022, në emisionin informativ-argëtues „E dua Maqedoninë”, ka transmetuar reklamë të fshehur audiovizuale komerciale komunikimi për enë gatimi që i shiste „Komodita houm”, që është në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 2 nga LSHMAAV.

3. Obligohet Sektori për punë juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për marrjen e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente për transmetuesin e përmendur.

4. Ekzemplar nga Konkluzioni t’u dorëzohet:

- Udhëheqësve të sektorëve në Agjenci,
- Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndëve sipas procedurës administrative,
- , - Sektori për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë,
- Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme-arkivi i Agjencisë.

Nr.02-2038/3
20.05.2022
Shkup

Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v